



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Datë: 31/03/2020

PJESA I E KONTRATËS

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Dhe

NSH "3 D Project", adresa: **Prishtine, rruga "Muharrem Fejza"** Bll. C13A Nr.17, me numër unik identifikues 810494740 (70119238), përfaqësuar nga Selami Bugaaku (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Titulli: Hartimi i projekteve per infrastrukturë rrugore

Numri i prokurimit: 616 19 122 212

Neni 1 Lënda 1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen shërbimeve per **Hartimin e projekteve per infrastrukturë rrugore** sipas specifimeve teknike detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrjeve. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej shërbime në **bazë** të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve qe duhet te për formohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjérën prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të **porosise** shërbime më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (*loti*) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdor këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë – shërbime të përmendura në 1.1.

1.4 Ofruesi i shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasi ra për disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon në një periudhë prej **12 muajsh**.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve te caktuara do të jetë **45 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve - për hartimin e projekteve per infrastrukturë rrugore janë paraqitura në Ofertën Financiare te përshkrimi i çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi.

Çmimi njësi i ofertës është 2.41 euro (dy euro e katerdhjete e një eurocent), ndërsa çmimi njësi i poentuar: 0.08 Euro (Zero euro e zero tetë eurocent).

Vlera e parashikuar e kësaj kontrate sipas Deklaratës se Nevojave dhe Disponueshmërisë se Fondeve është 180,000.⁰⁰ euro (Njëqindë e tetëdhjetë mijë) euro

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën për çdo muaj në bazë të shërbimeve të kryera sipas raportit të Menaxherit dhe mbikëqyrësit të projektit nga Komuna. Çdo pagesë duhet te aprovohet nga Zyrtari i prokurimit dhe zyrtari i financave te Autoritetit Kontraktues.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen Shqipe në katër origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues				Për Kontraktuesin	
Zyra e Prokurimit		Për Zyrtarin Kryesor Administrativ			
Emri dhe mbiemri: <i>PP</i>	Zekë Bardhaj	Emri dhe mbiemri:	Shpend Ahmeti	Emri dhe mbiemri:	<i>SELMI BUGAQRU</i>
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Kryetar i Komunës	Pozita:	<i>DRESTOK</i>
Nënshkrimi:	<i>SHK</i>	Nënshkrimi:	<i>SHK</i>	Nënshkrimi:	<i>SP</i>
Data:	<i>31.03.2020</i>	Data:	<i>31.03.2020</i>	Data:	<i>03.04.2020</i>
Vula:		Vula:		Vula:	



PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të shkruar nga palel, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është pale në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVKE saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVKE.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënierë e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontrahohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autcritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njofimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Detyrimet

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e murdur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:

- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kupuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkësë për zgjatjen e periudhës së realizimit përfunduar të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvësce kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofresit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofresin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmëtet, shtrëngatat, vetëtima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi përfunduar obligejet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes përfunduar ose vonusar, përfundimisht ose përfundimisht nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit përfunduar obligejet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përvësce nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdohë t'i realizojë obligejet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative përfunduar ndonjë obligej që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përvësce nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9

Ndërprerja e Kontraktues nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim përfunduar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar përfunduar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor përfunduar për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* përfunduar me korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjeter me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm përfunduar për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfunduar përfunduar shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, përfunduar shërbimet, shumë se 10% e pagesave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpresë kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10

Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si resultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të **kryejë** Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar **dënimit** për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 **ditësh** pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të **veprojnë** sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i **shërbimit** është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatate tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i **çaktuari** nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në **tenderin** e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti **Kontraktues** mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk **kryejnë** detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të **identikuara**.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti **Kontraktues** do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në **dispozicion** të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që **ky** i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të **specifikuara** në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të **zbresë** dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-**ekzekutimi** i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërsëi, dëmet e likuiduara të **parapara** në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofroresi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofroresi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosire, dhe në këtë rast Ofroresi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroresi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofroresi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroresit të Shërbimeve.

14.2 Garacioni do të vazhdohet të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofroresi i Shërbimit

15.1 Ofroresi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroresi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofroresi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikasi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroresi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofroresin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura

përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofrcesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofrcesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofrcesi i shërbimeve mund të informojë APP-ja për shkelje të tillë. APP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga APP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofrcesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofrcesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofrcesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofrcesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofrcesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të siperpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofrcesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbllimi

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizoterojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : Caktohet me Vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ
Siguria ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 18,000.00 € (tetëmbëdhjetë mijë Euro) për kohëzgjatjen prej 13 muajve me garacion bankar nga një bankë e licencuar ose kompani sigurimesh e licencuar nga BQ e Kosovës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin Kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Pagesat		Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën për çdo muaj në bazë të shërbimeve të kryera sipas raportit të Menaxherit dhe mbikëqyrësit të projektit nga Komuna. Çdo pagesë duhet te aprovohet nga Zyrtari i prokurimit dhe zyrtari i financave te Autoritetit Kontraktues.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Autoriteti Kontraktues ka te drejtën e inspektimit te kryerjes se shërbimeve. <u>Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është 13 muaj</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës , në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

DETYRË PROJEKTIMI

1. HYRJE

Kërkohet hartimi i projektit kryesor për:

- konstruksionin e rrugës me gjatësi L=...m', gjërsi B=...m, trotuare, bankina dhe veprat tjera arti të rrugës.
- mureve mbrojtëse nga BA.
- e urave deri 15 m' gjatësi dhe 4-8 gjërsi, nënkalimeve, mbikalimeve
- parkingjeve sipërfaqësore
- kanalizimin fekal, atmosferik dhe ujësjellës
- sinjalizimin horizontal dhe vertikal në gjatësinë e rrugës, parkingjeve sipërfaqësore
- ndriçimit publik
- rikonstruimi i rrugëve, trotuareve, parkingjeve etj..

FOTO E ZGJEDHUR NGA ORTO-FOTO (për terenin-pjesa ku do të bëhet projekti)

2. Fazat e projektimit

Zgjidhja ideore dhe Zgjidhja Kryesore

* Projekti kryesor për fazat: Rrugë, Kanalizim fekal, Kanalizim atmosferik , Ujësjellës, ndriçim publik.

3. Zgjidhja ideore

Zgjidhja ideore parashev mundësitet teknike të zgjidhjes e cila duhet të shërbejë si bazë për projektin kryesorë.

Projektuesi duhet të vlerësojë vizualisht zgjidhjen më të volitshme për konstruksionin e rrugës, lëshesave pllakore, mureve mbrojtëse për rrjetat e kanalizimit fekale, atmosferik dhe ujësjellës, elektrikës.

Për përgatitjen e projektit të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe elektrikës duhet të koordinohen punët me KRU "Prishtina" dhe KEK-KEDS, dhe para draftit final projektuesit duhet te marrin aprovin për pikën e kyçjes nga KRU,, Prishtina".

Hartimi i projektit të bëhet varësisht nga kapaciteti i rrugës dhe kërkesat përgjatë këtij aksi rrugor, si dhe studimi dhe definimi i lidhjeve me rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Pas shqyrtimit të përbashkët (projektuesit dhe investitorit) të zgjidhjeve ideore (së paku dy variante) do të përvetësohet varianti më i volitshëm për hartimin e projektit kryesor.

4. Zgjidhja ideore duhet të përmbajë:

- raportin teknik
- situacionin e rrugës, parkingjeve, urave, sinjalizimit, kanalizimeve dhe ujësjellësit P=1:500
- llogaritë hidraulike per kanalizim fekal, atmosferik dhe ujësjellësit,
- profilin gjatësor (rrugës, sinjalizimit, kanalizimeve dhe ujësjellësit) P=1:500/50
- profilin tërthorë P=1:100
- profilin karakteristik P=1:50
- muret mbrojtëse, urave BA
- përshkrimin e punëve kryesore
- paramasen dhe paralogarinë

5. Projekti kryesor duhet të përmbajë

5.1 Incizimi gjeodezik

Në incizimin gjeodezik do të paraqitet gjendja ekzistuese me të gjitha elementet dhe pikat e nevojshme për përgaditjen e projektit të shpronësimit. Gjerësia e incizimit të jetë 80m (nga 40 m në dy anët e rrugës llogaritur nga aksi).

5.2 Projekti i ujësjellësit dhe kanalizimeve

Përgatitja e projektit të ujësjellësit dhe kanalizimeve duhet të bëhet konform planeve rregulluese (aty ku ekzistojnë), PZHU-së, PZHKG-së dhe të koordinohen punët me KRU,,Prishtina”.

Gjatë përgatitjes se projektit të ujësjellësit dhe kanalizimeve duhen ;

- **INFORMATAT BAZIKE**
Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza - KUZ dhe ujërave te bardha -KUB
- **RAPORTI/PËRSHKRIMI TEKNIK**
Kushtet e Përgjithshme dhe te veçanta për Kanalizim Fekal
Testimi i rrjetit në joujëpërshkueshmëri
Mbrojtja në punë
Sistemi i lidhjeve për komunikim në punishte

Përgatitja për ndërtimin e kanalizimit

Kontrollimi dhe sigurimi i kualitetit

- **DIMENSIONIMI**
Llogaria hidraulike
- **VIZATIMET**
Situacioni
Profilet gjatësore
Detalet
- **PARAMASA DHE PARALLOGARIA**
Ndërtimi i kanalizimeve
- **FLETA PËRMBYLLËSE**
Literatura e përdorur
Softwerat e përdorur
Autorët

5.3 Projektin e ndriçimit publik dhe furnizimit me energji

Për përgatitjen e projektit të elektrikes duhet të konsultohet plani rregullues (aty ku ekziston) dhe të koordinohen punët me KEK-KEDS-in

5.4 Elaboratin gjeomekanik

Gjatë studimit gjeomekanik duhen te kryhen këto detyra me përbajtjet si më poshtë:

Detyrat;

1. Hulumtim gjeologjik i trases për te vrojtuar aspekte gjeologo-strukturale e litologjike të tij, si dhe infrastrukturën për rreth trases.
2. Realizimin e punimeve ne teren me marrje të mostrave për përcaktimin e veticë gjeomekanike të shtresave.
3. Matjet ne teren dhe percaktimin e aftesis mbajtese te shtresave.
4. Analizimi laboratorik i provave (mostrave)
5. Hartimi i Elabaratit gjeomekanik i cili duhet të përbajë këto kapituj:

Permbajtjet :

1. Pozicioni gjeografik i trases
 - Gjeomorfologjia, klima
2. Ndërtimi gjeologo-tektonik
 - Tektonika e rajonit dhe e zonës
 - Neoteknonika dhe seizmiciteti
3. Kushtet hidrogjeologjike

4. Kategorizimi i terenit

-Punimet fushore, analizat laboratorike

5. Kushtet gjeologo-inxhinierike

6. Përfundime e rekomandime.

Teksti i elaboratit të shoqërohet me grafiket përkatëse dhe me fotografi.

Elaborati për rrugën, urat, parkingjet dhe për mure mbrojtëse duhet të bëhet sipas kritereve të EUROCOD-it (numri i shpimeve dhe thellësia sipas nevojës, gjithëherë në koordinim me menaxherin e kontratës nga AK).

5.5 Projekti i shpronësimit

Projekti duhet të përbajtë gjitha të dhënat për ngastrat nëpër të cilat kalon rruga, ura, parkingjet (gjatesite e ngastrave bazë dhe gjatesite e pjesëve që i merr rruga, ura, parkingjet). Të gjitha pikat e ngastrave të kenë koordinatat sipas këtij sistemit Kosovaref.

Vërejtje: Per nevojat e hartimit te projekteve, kontraktori obligohet ti siguroj dokumentet kadastrale (duke perfshire fleten poseduese, kopjen e planit dhe manualin).

5.6 Projekti i sinjalizimit

Ky projekt duhet të përbajë

* Projektin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në kryqëzim të rrugëve dhe përgjatë rrugës me specifikimet teknike dhe përshkrimi teknik
(materialet e përdorura)

* Analiza lidhur me orientimin e komunikacionit (forma e qasjes së rrugëve, kryqëzimet dhe kategorizimi i rrugëve prioritare duke u bazuar ne rregullat e komunikacionit, vendkalimet, qasja dhe përshkrimi fizik për kalimin e personave me aftësi të kufizuar, etj).

5.7 Projekti kryesor rrugës, urave dhe parkingjeve

Projektuesit do te përgatisin Projektin kryesor me këto përbajtje minimale:

* RAPORTI TEKNIK

-Te dhënat e përgjithshme për projektin

-Lënda e projektit

-Paraqitura e shënimave gjeodezike, gjeologjike, gjeomekanike dhe hidrologjike

-Përshkrimi i hollësishëm teknik

-Llogaritjen e të gjitha elementeve të rrugës

-Paramasa dhe paralogaria

- Koordinatat e pikave kryesore dhe pikave detaile

- Koordinatat dhe kuotat e bazës gjeodezike në brezin rrugor.

* PJESA GRAFIKE

- Hartat me te dhënat mbi projektin P= 1:1000
- Incizimi gjeodezik (duke përfshirë të gjitha objektet dhe elementet tjera në brezin 2x40m nga mesi i rrugës)
- Profilet normale me detalet standarde (ne shkalle 1:100 (1:50), ne distance 25m, (dhe ne distance me te vogla ne vendet karakteristike),
- Plani i situacionit ne shkalle 1: 500, kurse profili gjatësor 1: 500/50
- Profilet tërthore dhe karakteristike ne shkalle 1:50
- Plani i nivelimit te udhëkryqeve dhe brezit rrugor
- Profili i masave
- Detalet standarde dhe jo standarde konstruktive
- Projekti kryesor i udhëkryqeve me planin e situacionit ne shkalle 1:100
- profili gjatësor ne shkalle 1:500/50
- Paraqitura detaile grafike e largimit te ujërave atmosferike dhe nëntokësore
- Detalet zbatuese
- Projekti i konstruksionit te rrugës
- Projekti i objekteve inxhinjerike (muret mbrojtëse, objektet për largimin e ujërave, urat me gjatësi deri në 15 m dhe gjërsi 4-8 m, parkingjeve me dispozita, llogari statike dhe të gjitha fazat tjera të nevojshme për këto objekte si kërkohen në ligjet dhe rregullat teknike)
- Projekti i sinjalizimit dhe pajisjes se rrugës
- Projektet e studimeve gjeoteknike, gjeologjike dhe hidrologjike
- Projekti i shpronësimit
- Projekti i mbrojtjes se ambientit
- Projekti i te dhënave gjeodezike
- Projekti i organizimit optimal për ndërtimin e rrugës
- Projekti i instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve
- Projekti i ndriçimit publik dhe i furnizimit me energji elektrike.

5.8 DETYRA PROJEKTUESE PËR ELEKTRIKË

Sipërfaqja e ndriçuar e hapësirës duhet të përfshijë ;

- Ndriçimin e rrugës
- Ndriçimin e trotuareve dhe stazës së bicikletave
- Instalimet nëntokësore- kablloviqe

Detyra Projektuese për Instalimet elektrike, infrastrukturore dhe ndriçimit publik duhet të përmbajnë;

- **Pjesa tekstuale**
- **Pjesa grafike**

*** Pjesa tekstuale e projektit duhet të përmbajë;**

- Përshkrimin teknik.
- Llogaritja fotometrike e ndriçimit
 - Ilogaritja e rezistencës së tokëzimeve
 - Ilogaritja e rënjes së tensionit
 - aspektet e mbrojtjes për qarqet rrymore
- **Specifikimi- materializimi i materialeve (elementeve) që do të përdoren.**
- Specifikimi i pasqyrës së shqyrtimeve dhe atesteve

përshkrimi i kërkesave për ateste
- Përshkrimi i masave mbrojtëse gjatë ekzekutimit të projektit.
- Paramasa dhe Paralogaria.

*** Pjesa grafike e projektit duhet të përmbajë;**

- Situacionin me të gjitha elementet sipas kushteve teknike.
- Vizatimet, prerjet, dukjet, detalet me përpjesë sipas kushteve teknike të detaluara dhe materializuara sipas përpjesave teknike.

6. Forma e dorëzimit të projektit

Projekti kryesor me te gjitha elementet e kërkua sipas dokumentacionit tenderues, detyrës projektuese dhe dokumentacionin tjetër teknik (të dhënat e OE me stafin e angazhuar në projektim, kontrata e kontraktuar, vendimin e ekipit të mbikqyrjes nga investitori dhe shenime tjera që janë në të mirën e projektit) duhet te punohet ne 5 (pese) kopje me lidhje të fortë, dhe 5 CD. (digitale në programet e aplikueshme CAD-DWG, PDF),ne gjuhen shqipe.

-Gjatë projektimit të infrastrukturës, projektuesi duhet të bazohet në të dhënrat nga planet **rregullative aty ku ka**, ndërsa në pjesët ku nuk ekzistojnë Prr-ve, të bazohen në PZHU, PZHK dhe planet **tjera strategjike** të komunës.

-Para përvetësimit të variantës kryesore të instalimeve, projektuesi para mbikëqyrjes së caktuar **nga AK**, duhet t'i paraqesë edhe variantet (s'paku dy) e mundëshme të zgjidhjeve bazuar në specifikat grafike dhe standardeve teknike për materialet e propozuara.

Me rastin e dorëzimit të Projekteve Kryesore nga hartuesi (kontraktori) te investitorit, këto projekte **kalojnë** në pronësi të investitorit dhe i takojnë të gjitha të drejtat autoriale po këtij investitorit mbi këto **projekte**.


HARTIMI I PROJEKTEVE PER INFRASTRUKURE RRUGORE						
Nr.	Emërtimi i pozicionit	Njësie	Sasia	Çmimi njësi me TVSH(€)	Çmimi njësi me poentim (€)	Poentimi
1	Incizimi gjeodezik për projektimin e rrugëve (ky pozicion është paraparë për m' (per meter gjatësi të rrugës dhe gjerësi 2x40 m ,nga aksli i rrugës).	m'	1	0.15	0.015	10
2	Incizimi gjeodezik (ky pozicion është paraparë përrrugët trotuaret, parkingjet dhe hapsirat tjera) gjatë rekonstruimit të rrugëve,parqeve dhe hapëslrave.	m ²	1	0.7	0.021	3
3	Incizimi gjeodezik (ky pozicion është paraparë për infrastrukturen vijore siq janë kanalizimet , ujësjellset, rrjetat elektrike dhe instalimet tjera vlore).	m'	1	0.83	0.0249	3
4	Projekti kryesor i rrjetit të Ujësjellësit.	m'	1	0.01	0.0003	3
5	Projekti Kryesor i Kanalizimit atmosferik.	m'	1	0.01	0.0003	3
6	Projekti i Kryesor i kanaleve të hapura për ujëra atmosferke.	m'	1	0.01	0.0001	1
7	Projekti Kryesor i Kanalizimit fekal.	m'	1	0.01	0.0006	6
8	Projekti kryesor i Kanalizimit kabllor energjetik dhe optic	m'	1	0.01	0.0002	2
9	Projekti kryesor i ndriçimit publik	m'	1	0.01	0.0001	1
10	Elaborati gjemekanik-meter gjatesi te rruges (sipas kërkesave te detyrave projekteuse)	m'	1	0.01	0.0007	7
11	Projekti i Sinalizimit horizontal dhe vertikal	m'	1	0.01	0.0009	9
12	Projekti i rrugëve urbane (gjerësia e rrugës)					
a.	B=4-6 m	m'	1	0.01	0.0009	9
b.	B=6-12m	m'	1	0.01	0.0007	7
c.	B=12-30 m	m'	1	0.01	0.0002	2
13	Projekti kryesor i rrugëve rurale (gjerësia e rrugës)					
a.	B=4-6 m	m'	1	0.01	0.0009	9
b.	B=6-12m	m'	1	0.01	0.0006	6
14	Projekti i rikonstruimit të rrugëve, trotuareve, parkingjeve, sheshive dhe hapsirave tjera, duke perfshir edhe rekonstruimin e Infrastrukturës eezistuese nëntoksore.	m ²	1	0.54	0.0108	2
15	Projekti kryesor i Mureve mbroitese	m'	1	0.01	0.0002	2
16	Projekti i stabilitimit të dheut me pilota(hunje)	m'	1	0.01	0.0001	1
17	Hartimi i projektit për rregullimin e nyjeve të komunikacionit (duke përfshirë semaforë , rrëthrrrotullim dhe nyje tjera të nevojshme të rruges)	copë	1	0.01	0.0001	1
18	Projekti i mbikalimeve dhe nënkalimeve të mjeteve motorrike dhe këmbësorëve.	m'	1	0.01	0.0001	1
19	Projekti i urave të vogla deri ne 15m gjatësi dhe gjerësi 4-8 m	m'	1	0.01	0.0002	2
20	Projekti i shpronësimit (nenkuptohet elaborati i shpronësimit per te dy anet e rruges). Vërejtje: Per nevojat e hartimit te projekteve, kontraktori obligohet ti siguroj dokumentet kadastrale (duke perfshire fleten poseduese, kopjen e planit dhe manualin).	m'	1	0.01	0.001	10
	Gjithsej			2.41	0.0799	100

Ofertat do te vleresohen ne baze te çmimit te per gjithshem te poentuar . Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjata hapjes publike.



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:	N.SH.3D PROJECT
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT OE:	SELAMI BUGAQKU
NËNSHKRIMI:	
DATA:	04.01.2020
VULA:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
Zyrtari Kryesor Administrativ

nr. 16-370/03-32211/20 datë: 10.02.2020

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

V E N D I M

Caktohen Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i realizimit te projektit për kontratën **Hartimi i projekteve per infrastrukturre rrugore**, me numër të prokurimit: **616 19 122 212**.

1. Jeton Zherka, caktohet menaxher i kontratës.
2. Mbikëqyrës për realizimin e kontratës sipas pikës 1 te këtij vendimi caktohet:
 - a) Bujar Rama
 - b) Bashkim Statovci
 - c) Sevdije Drenovci
 - d) Krenar Xhaferi
3. Menaxheri i kontratës, obligohet qe të hartoj një Plan të te Menaxhimit te Kontratës, duke përdorur formularin Standard te miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e te dy palëve (Menaxherit te kontratës se AK dhe Menaxherit te Kontratës se OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar te planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
4. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Zyrtari Kryesor Administrativ
Shpend Ahmeti

Kopje: Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrësve te kontratës;
Departamentit te Prokurimit;
Drejtoret te Drejtorisë Përkatëse; dhe
Arkivit të Komunës-së